

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

PKL-KZZ-30/10

Më 1 shkurt 2011

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Martti Harsia si Kryetar i kolegjit, nga gjyqtarët e EULEX-it Lars Dahlstedt dhe Charles L Smith III dhe nga gjyqtarët kosovarë të Gjykatës Supreme të Kosovës, Emine Mustafa dhe Salih Toplica si anëtarë të kolegjit, në praninë e Adnan Isufit si Këshilltar ligjor i EULEX-it, në cilësinë e procesmbajtësit,

Në lëndën penale P nr 628/04, të Gjykatës së Qarkut të Gjilanit kundër të pandehurve:

Burim Ramadani, emri i babait _____, emri i nënës _____, në _____, në _____ i _____ dhe _____, ka qenë _____,


Arsim Ramadani, emri i babait _____ emri i nënës _____ në _____

Arben Kiqina, emri i babait _____ emri i nënës _____, në _____

Blerim Kiqina, emri i babait _____ emri i nënës _____

Të dënuar me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Ap-Ka 293/06 për pesë vepra penale të Vrasjes së rëndë dhe një Vrasje e rëndë në tentativë, sipas Nenit 30, par. 1 dhe 2 (pikës 1) dhe Nenit 3 të Ligjit Penal të KSAK, lidhur me Nenin 19 dhe 22 të KP të RSFJ-së.

Duke vendosur rreth Kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura nga avokatët mbrojtës Bejtush Isufi, (bashkë-nënshkruar nga Linn Slattengreen), Haxhi Millaku, Vahide Braha, Mahmut Halimi dhe Ibrahim Dobruna për të pandehurit Burim Ramadani, Arben Kiqina, Arsim Kiqina dhe Blerim Kiqina, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Gjilanit P nr 162/03, të datës 07.04.2005, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, AP 393/06, të datës 20.05.2008 dhe kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, API 04./09 të datës 16.09.2009,



Sipas Nenit 454, par. 1 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (*tash e tutje* "KPPPK"¹), pas seancës së këshillimit dhe të votimit të mbajtur më 1 shkurt 2011, Gjykata Supreme e Kosovës nxjerr këtë:

AKTGJYKIM

Për refuzimin e Kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura nga avokatët mbrojtës Bejtush Isufi, (bashkë-nënshkruar nga Linn Slattengreen), Haxhi Millaku, Mahmut Halimi, Vahide Braha dhe Ibrahim Dobruna në emër të të pandehurve Burim Ramadani, Arsim Ramadani, Arben Kiqina dhe Blerim Kiqina, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Gjilanit P nr 162/03 të datës 07.04.2005, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës AP 393/06, të datës 20.05.2008 dhe kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës API 04/09 të datës 16.09.2009 si të PABAZË dhe për vërtetimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, të nxjerrë në shkallën e dytë e cila është vërtetuar nga shkalla e tretë, sipas Nenit 456 të KPPK-së.


ARSYETIM

I. Historia e procedurës

Më 20 gusht 2001, rreth orës 23:17 hrs janë vrarë Hamëz Hajra, gruaja e tij Miradija, i biri i tij Xhevdeti dhe vajzat e tij Mimoza dhe Adelina përgjatë një ruge të ngushtë të paasfaltuar ndërmjet fshatrave Baicë dhe Tërstenik. Më herët kishin qenë në një dasmë të një të afërmi të tyre në fshatin Baicë. Pasi kishin lënë dasmën, familja Hajra po udhëtonin së bashku në një veturë të cilën po e ngiste Xhevdet Hajra, me Hamzën e ulur në ulësen e përparme të bashkudhëtarit, ndërsa gruaja dhe vajzat ishin të ulura prapa dhe në rrugë për në shtëpinë e tyre në Glllogovc. Posa vetura nisi të kalonte ngadalë një urë të vjetër druri, vajza e tyre Pranvera dëgjoi një zë në shqip duke thirrur "nda!" dhe pastaj zërin e një breshërie automatike. Plumbat filluan ta shpartallonin veturën ndërsa Pranvera uli kokën në prehër dhe qëndroi në atë pozitë. Të gjitha dritaret e veturës përveç njëres u qëlluan dhe kishte shumë vrima të plumbave në krahun e djathtë të veturës. Si pasojë e plagëve të marra nga armët e zjarrit vdiqën Hamëz Hajra, gruaja e tij, djali dhe dy vajzat, ndërsa Pranvera mbijetoi.

Më 7 shkurt 2003, pas përfundimit të hetimeve Prokurori publik ngriti aktakuzën kundër të akuzuarve Skender Halilaj, Burim Ramadani, Arben Kiqina, Arsim Ramadani, Zeqir Kiqina, Florim Kiqina dhe Blerim Kiqina duke i ngarkuar ata për Vrasjen e personave Hamez Hajra, Miradije Hajra, Xhevdet Hajra, Mimoza Hajra dhe Adelina Hajra, duke vepruar në bashkëpunim dhe duke ndihmuar dhe duke nxitur njëri tjetrin, në kundërshtim me Nenin 30, par. 2 (1) (3) (4) (5) të Kodit Penal të Kosovës, lidhur me Nenet 22 dhe 24 të Kodit Penal të Jugosllavisë; për Vrasje në tentativë të Pranvera Hajrës duke vepruar në bashkëpunim dhe duke ndihmuar dhe duke nxitur njëri tjetrin, në kundërshtim me Nenin 200 të Kodit Penal të Kosovës, lidhur me Nenet 22 dhe 24 të Kodit Penal të Jugosllavisë;

¹ Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës ka hyrë në fuqi në prill të vitit 2004, dhe më vonë është ndryshuar.



Marrëveshje për të kryer veprën penale duke vepruar në bashkëpunim dhe duke ndihmuar dhe duke nxitur njëri tjetrin, në kundërshtim me Nenin 196 të Kodit Penal të Kosovës, lidhur me Nenet 22 dhe 24 të Kodit Penal të Jugosllavisë.

Më 5 shkurt 2003 Prokurori publik ka ngritur aktakuzë kundër Agim Xhylanit, Bekim Morinës, Adem Kiqinës dhe Muharrem Xhemajlit duke i ngarkuar për bashkëpunim, ndihmë dhe nxitje Skender Halilajn, Arsim Ramadanin, Burim Ramadanin, Arben Kiqinën, Florim Kiqinën and Blerim Kiqinën, për vrasje të Hamëz Hajrës, Miradije Hajrës, Xhevdet Hajrës, Mimoza Hajrës dhe Adelina Hajrës në kundërshtim me Nenin 30 (2) nënpar. (3) dhe (4) të Kodit Penal të Kosovës lidhur me Nenet 22 dhe 24 të Kodit Penal të Jugosllavisë; për bashkëpunim, ndihmë dhe nxitje Skender Halilajn, Arsim Ramadanin, Burim Ramadanin, Arben Kiqinën, Zeqir Kiqinën, Florim Kiqinën dhe Blerim Kiqinën për vrasje në tentativë të Pranvera Hajrës, në kundërshtim me Nenin 30, par. 2 (1) (3) (4) (5) të Kodit Penal të Kosovës; Moslajmërim i përgatitjes së veprës penale, duke vepruar në bashkëpunim, në kundërshtim me Nenin 172 (2) të Kodit Penal të Kosovës, lidhur me Nenin 22 të Kodit Penal të Jugosllavisë; Moslajmërim i veprës penale apo i kryerësit, duke vepruar në bashkëpunim, në kundërshtim me Nenin 173 (2) të Kodit Penal të Kosovës, lidhur me Nenin 22 të Kodit Penal të Jugosllavisë; Mbështetje e kryerësit pas kryerjes së veprës penale, duke vepruar në bashkëpunim, në kundërshtim me Nenin 174 (3) të Kodit Penal të Kosovës, lidhur me Nenin 22 të Kodit Penal të Jugosllavisë; Mbështetje e kryerësit pasi ai ose ajo ka kryer veprën penale, në kundërshtim me Nenin 174 (3) të Kodit Penal të Kosovës.


Më 3 korrik 2002, Prokurori publik ka ngritur aktakuzën kundër Kimete Krasniqit duke e akuzuar me Vrasje në tentativë të Hamëz Hajrës për motive të përftimit personal, hakmarrjes së paskrupullt dhe për motive të tjera të ulëta ose për gjakmarrje, duke vepruar në bashkëpunim, në kundërshtim me Nenin 30 (2), nënpar. 3 dhe 4 të Kodit Penal të Kosovës dhe Nenet 19 dhe 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe për Mbajtje të paligjshme në pronësi të armëve, në kundërshtim me Nenin 199 (1) të Kodit Penal të Kosovës dhe të Nenit 8.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/7;

Më 11 shtator 2002, Prokurori publik ka ngritur aktakuzën kundër Skender Halilajt duke e akuzuar me Vrasje në tentativë të Hamëz Hajrës për motive të përftimit personal, hakmarrjes së paskrupullt dhe për motive të tjera të ulëta ose për gjakmarrje, duke vepruar në bashkëpunim, në kundërshtim me Nenin 30 (2), nënpar. 3 dhe 4 të Kodit Penal të Kosovës dhe Nenet 19 dhe 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Më 16 shtator 2003 u bë konsolidimi i aktakuzës me anë të vendimit të trupit gjykues dhe vendi i gjykimit u ndryshua nga Prishtina në Gjilan me anë të vendimit të PSSP²-së të datës 7 tetor 2003.

Më 7 prill 2005, Gjykata e Qarkut si gjykatë e shkallë së parë shpalli aktgjykimin. Të pandehurit Burim Ramadani, Arben Kiqina, Arsim Ramadani dhe Blerim Kiqina u

² Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara



shpallën fajtor së bashku me të pandehurit e tjerë të përfshirë në aktgjykim. Megjithatë, pasi që të pandehurit e tjerë nuk janë objekt trajtimi i procedurës së tanishme që ka të bëjë me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme nuk e sheh të arsyeshme t'u referohet më tej. Të pandehurit Burim Ramadani, Arben Kiqina dhe Arsim Kiqina kanë marrë dënimin unik burgim afatgjatë prej 30 vjetësh ndërsa i pandehuri Blerim Kiqina është dënuar me 10 vjet burgim.

Duke vendosur për ankesat, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Ap-Kaz-393/06 të datës 20 maj 2008, ka ndryshuar pjesërisht Aktgjykimin P nr 162/2003, të datës 7 prill 2005 të Gjykatës së Qarkut të Gjilanit.

Të pandehurit Burim Ramadani, Arben Kiqina, Arsim Kiqina dhe Blerim Ramadani u shpallën fajtorë nga me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Ap-Ka 293/06 për pesë vepra penale të Vrasjes së rëndë dhe një Vrasje të rëndë në tentativë, sipas Nenit 30, par. 2 dhe 2 (pika 1) dhe 3 të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (LP të KSAK-së), lidhur me Nenet 19 dhe 22 të KP të RSFJ-së. Për këto vepra penale, të akuzuarit Burim Ramadani, Arben Kiqina, Arsim Ramadani u dënuan secili me nga 30 vjet burgim, ndërsa i akuzuari Blerim Kiqina u dënua me 11 vjet burgim.


Më 16 shtator 2009, Gjykata Supreme e Kosovës duke vendosur në shkallën e tretë ka refuzuar ankesat e paraqitura nga avokatët mbrojtës në emër të të pandehurve Burim Ramadani, Arben Kiqina dhe Arsim Kiqina duke i vlerësuar ankesat si të pabaza, përderisa ankesën e avokatit mbrojtës të të pandehurit Blerim Kiqina e ka hedhur poshtë si të papranueshme.

Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Gjilanit P nr 162/03 të datës 07.04.2005, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës AP 393/06, të datës 20.05.2008 dhe kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës API 4/09 të datës 16.09.2009, Avokatët mbrojtës Bejtush Isufi (bashkë-nënshkruar nga Linn Slattengreen), Haxhi Millaku, Vahide Braha, Mahmut Halimi dhe Ibrahim Dobruna kanë paraqitur Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë në emër të të pandehurve Burim Ramadani, Arben Kiqina, Arsim Kiqina dhe Blerim Kiqina.

Këto kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë janë përcjellë në Gjykatën Supreme të Kosovës më 22 shkurt 2010. Lënda i është dërguar ZPSHK-së për dhënien e mendimit.

Me parashtrësën KMLP II 28/2010 të datës 23 qershor 2010, Zyra e Prokurorit të Shtetit ka dhënë përgjigjen duke propozuar si më poshtë:

- 1) Të **hedhet poshtë** Kërkesa e paraqitur nga avokati Mahmut Halimi në emër të të pandehurit Burim Ramadani dhe nga avokati Bejtush A. Isufi (bashkë-nënshkruar nga Linn Slattengren) në emër të të gjithë të pandehurve si **e papranueshme** sipas Nenit 452 (1), 453 (2) pika 2 dhe Nenit 454 (92) të KPPK-së; dhe/ose propozimi shtesë që nëse Gjykata Supreme i konsideron të pranueshme kërkesat t'i refuzojë ato si të pabaza, sipas Nenit 456 të KPPK-së;



- 2) Të Refuzohen Kërkesat e paraqitura nga avokatët mbrojtës Ibrahim Dobruna, Haxhi Millaku dhe Vahide Braha në emër të Arben Kiqinës, Arsim Ramadanit dhe Burim Ramadanit si të pabazuara sipas Nenit 456 të KPPK-së.

II. Kërkesat për Mbrojtje të Ligjshmërisë;

Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga avokatët mbrojtës Bejtush Isufi,(e bashkë nënshkruar nga Linn Slattengreen), Haxhi Millaku, Mahmut Halimi, Vahide Braha dhe Ibrahim Dobruna pretendojnë Shkelje të Ligjit Penal, Shkelje Esenciale të Ligjit mbi Procedurën Penale, Shkelje tjera të Dispozitive të Ligjit mbi Procedurën Penale (që ndikuan në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor).

III. Gjetjet e Gjykatës Supreme

Në vlerësimin e Kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës vërtetoi siç vijon:

a. Të gjitha Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura nga avokatët mbrojtës janë të lejueshme. Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se kërkesat janë të paraqitura para gjykatës kompetente në përputhje me Nenin 454 par 1 nga personat e autorizuar dhe brenda afatit kohor në përputhje me Nenin 452 par 3 të KPPK-së.


b. Dukshëm avokatët mbrojtës Mahmut Halimi në përfaqësim të Burim Ramadanit dhe Bejtush Isufi (bashkë nënshkruar nga Linn Slattengreen), ishin të autorizuar nga familjarët e të pandehurit. Pasi Gjykata i ka pyetur të pandehurit se a pajtohen të përfaqësohen nga këta avokatë mbrojtës, të gjithë ata janë përgjigjur pozitivisht. Si pasojë u refuzua Mendimi i Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Kosovës për t'i hedhur poshtë Kërkesat e avokatit Mahmut Halimi në emër të të pandehurit Burim Ramadani dhe të avokatit Bejtush A. Isufi (bashkë nënshkruar nga Linn Slattengreen).

c. Gjykata Supreme e Kosovës në seancë vendosi siç përcaktohet me Nenin 454 paragrafin I të KPPK-së. Njoftimi i palëve për këtë seancë nuk ishte i nevojshëm.

d. Të gjitha Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura nga avokatët mbrojtës megjithatë janë të PABAZUARA.

Kolegji me respekt vëren se dykuptimësia dhe gjatësia e madhe e disa kërkesave që përmbajnë përsëritje të shumta të çështjeve të adresuara, disa prej të cilave edhe pse të cilësuar nga ankuesi si shkelje të ligjit penal dhe të ligjit për procedurën penale, në fakt më shumë i përkasin çështjes së gjendjes faktike (vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të fakteve).

Kjo gjykatë megjithatë në vlerësimin e vet është e kufizuar nga Neni 451 dhe Neni 455 i KPPK-së lidhur me bazat e kërkesës dhe argumenteve të ngritura nga pala që paraqet kërkesën.



Gjykata Supreme e Kosovës në fillim i morri parasysh pikat që ishin ngritur nga të gjithë dhe/ose shumica e avokatëve mbrojtës, për të vazhduar me pikat specifike të adresuara nga avokatët mbrojtës individualë me qëllim të shmangies së dyfishimit.

Në Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë avokatët mbrojtës kundërshtojnë si në vijim:

A. SHKELJET SUBSTANCIALE TË DISPOZITAVE TË PROCEDURËS PENALE DHE SHKELJET TJERA TË DISPOZITAVE TË PROCEDURËS PENALE.

I. PËRBËRJA E GABUAR E KOLEGJIT TË SHKALLËS SË PARË

Sikur edhe në ankesat e mëparshme në këtë lëndë, avokatët mbrojtës përsëri parashtrojnë se gjykata e shkallës së parë nuk ishte e përbërë si duhet pasi që ishte e përbërë prej tre gjyqtarëve në vend të pesë gjyqtarëve (kolegj i vogël). Avokatët mbrojtës më tutje pretendojnë se zëvendësimi i anëtarit të gjyqimit në seancën e datës 24 korrik 2004 e tutje ishte në kundërshtim të Nenit 364 par 1 pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Penale (tash e tutje "LPP³"), dhe Nenit 403 par 1 pika 1 e KPPK-së.

Ky kolegj vëren se përbërja e gabuar e kolegjit përbën shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale. Shkeljet e dispozitave të procedurës penale mbi përbërjen e kolegjit janë të natyrës "absolute". Si të tillë gjykata është e obliguar *ex officio* të shqyrtojë nëse kolegji i cili lëshon aktgjykimin është i përbërë në përputhje me dispozitat e procedurës penale madje edhe nëse kjo çështje nuk ngrihet nga palët.

Në këtë kontekst vlen të përmendet se gjykata vazhdimisht ka rishikuar dhe shqyrtuar këtë çështje në mënyrë shteruese në instancat e mëparshme dhe në vazhdimësi ka marrë qëndrim, me të cilin ky kolegj me respekt pajtohet, se trupi gjykues ishte i përbërë në përputhje me ligjin.

Në këtë pikë, Gjykata Supreme e Kosovës e konsideron si jetike të përsërisë faktin se caktimi i gjyqtarëve ndërkombëtarë në çështjet penale është bërë në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/64 të datës 15 dhjetor 2000 Mbi Emërimin dhe Shkarkimin nga Detyra të Gjyqtarëve Ndërkombëtarë dhe Prokurorëve Ndërkombëtarë⁴.


Në këtë kontekst veçanërisht Neni 2.1 i rregullores së përmendur më lart shkruan:

"Me rastin e miratimit nga ana e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm në pajtim me nenin 1 më lart, Departamenti i Drejtësisë menjëherë do të caktojë "

(a) një prokuror ndërkombëtar,

³ Ligji mbi Procedurën Penale, viti 1986 (Gazeta Zyrtare Nr 26/86)

⁴ Shih Rregulloren e UNMIK-ut 2000/6, të datës 12 shkurt 2000, të ndryshuar me Rregulloren Nr 2000/64 të datës 15 dhjetor 2000.



(b) një gjyqtar hetues ndërkombëtar dhe/ose

(c) një koleg gjykues të përbërë vetëm nga tre (3) gjyqtarë duke përfshirë së paku dy gjyqtarë ndërkombëtarë prej të cilëve njëri do të jetë kryesues,

Gjersa dispozitat e rregullores së cituar duket se mbulojnë njëra tjetrën me dispozitat e procedurës penale përkatësisht Neni 24 par 1 i KPPK-së i cili parasheh një koleg të madh në lëndët e dënueshme me burgim së paku deri me pesëmbëdhjetë vjet, mbizotërimi i kësaj të parës nuk është në dyshim. Ky koleg e gjen të arsyeshme t'i referohet vështrimeve të mëposhtme të Gjykatës Supreme të Kosovës përkitazi me temën e njëjtë në një lëndë tjetër që lidhet me këtë lëndë:

“çështja e rregullimit të dyfishtë në mes të dispozitave të KPPK-së dhe Rregulloreve të UNMIK-ut të cituara më lart duhet të zgjidhet sipas parimit të specialitetit, d.m.th.: Neni 2.1 pika (c) në mënyrë të veçantë duke adresuar caktimin e gjyqtarëve ndërkombëtarë në lëndët penale, është më me prioritet ndaj dispozitave të KPPK-së e cila në mënyrë të gjerë e adreson përbërjen e trupave gjykues”⁵.

Sa i përket pretendimeve rreth ndërrimit të anëtarëve të trupit gjykues, Gjykata Supreme e Kosovës i referohet procesverbalit të gjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan të datës 24 qershor 2004 që pasqyron ndryshimin e anëtarëve të kolegjit.

Nga shkresat e lëndës është e qartë se kryetari i kolegjit ka lajmëruar ndërrimet në përbërjen e trupit gjykues. Si rezultat i kësaj kryetari i kolegjit shënoi në procesverbal se të gjitha shënimet e mëhershme ishin lexuar. Më tutje kryetari i kolegjit shënoi se *“anëtari i ri i trupit gjykues i ka marrë të gjitha shkresat e gjykimit, aktakuzat, të gjitha dhe se gjyqtari i ri i ka lexuar ato dhe ai është mjaft i njoftuar me këtë lëndë”⁶.*


Palët në procedurë qartë ishin ftuar të komentojnë nëse kishin ndonjë vërejtje lidhur me përbërjen e re të trupit gjykues. Kryetari i kolegjit po ashtu i ftoi të gjitha palët të deklaroheshin se a konsiderojnë se ishin lexuar të gjitha procesverbalet pasi që i tërë procesverbalit ishte pjesë e shënimeve, apo dëshirojnë t'i lexojnë edhe një herë të gjitha procesverbalet.

Asnjë vërejtje nuk ishte bërë mbi këtë çështje nga palët në procedurë. Të gjithë avokatët mbrojtës u pajtuan si dhe qëndrimi i prokurorit publik ishte të konsiderohet se ishin lexuar të gjitha procesverbalet në të mirë të shpejtimin të procedurës në këtë lëndë.

Pasi nuk është pranuar asnjë vërejtje dhe pas shfaqjes së pëlqimit të palëve në procedurë gjykata lexoi deklaratat e dhëna para kolegjit të mëparshëm.

⁵ Lënda Jeton Kiqina, Aktgjykimi Pkl-Kzz 31/10, i datës 01 nëntor 2010, faqe 5, versioni në gjuhën Angleze

⁶ Procesverbalit i Gjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, i datës 24 qershor 2004, faqe 6 dhe 7, versioni në gjuhën Angleze.



Në këtë kontekst, Neni 345 paragrafi 1 i KPPK-së lexon:

“Kur përbërja e trupit gjykues është ndryshuar, shqyrtimi gjyqësor i shtyrë fillon rishtas. Por, në rastin e tillë, trupi gjykues pas dëgjimit të palëve mund të vendosë që dëshmitarët dhe ekspertët të mos merren sërish në pyetje dhe të mos bëhet këqyrja e re e vendit, por të lexohen deklaratimet e dëshmitarëve dhe ekspertëve të dhëna në shqyrtimin e mëparshëm gjyqësor apo të lexohet procesverbali i këqyrjes së vendit”.

Kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë i ka plotësuar të gjitha kushtet e dispozitës së cituar.

Përveç kësaj vlen të përmendet se ndryshimi i përbërjes së kolegjit dhe leximi i deklaratave nuk ishte çështje kundërshtimi deri në përfundimin e procedurës së gjykimit. Vetëm pas përfundimit të gjykimit avokatët mbrojtës filluan të kundërshtonin rreth përbërjes së gabuar të trupit gjykues dhe të vënin në dyshim paanshmërinë e anëtarëve të rinj të kolegjit. Avokatët mbrojtës megjithatë nuk i ofruan gjykatës asnjë justifikim të arsyeshëm që do ta dëshmonte paanshmërinë e anëtarit të ri të kolegjit.

Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka gjetur asnjë rrethanë të re në këtë lëndë që do të vinte në dyshim paanshmërinë e anëtarëve të rinj të kolegjit të Gjykatës së Qarkut.

Prandaj Gjykata Supreme e Kosovës e konsideron kërkesën e mbrojtjes të pabazuar në këtë pikë.

2. PAKUPTUESHMËRIA E DISPOZITIVIT TË AKTGJYKIMEVE TË SHKALLËS SË PARË DHE DYTË.

Ankuesit pohojnë se dispozitivi i aktgjykimeve të kundërshtuara të lëshuara është i pakuptueshëm, të parregullta në brendi apo të papajtueshme me bazat e aktgjykimit. Avokatët mbrojtës pretendojnë se aktgjykimi nuk përmban një përcaktim të saktë të veprës penale pasi që nuk ekziston asnjë “*vrasje e rëndë e qëllimshme*” sipas dispozitave të ligjit penal dhe se arsyetimi i aktgjykimit është i paqartë, kundërrthënës me deklaratat e të akuzuarve, dëshmitarëve, dokumentacionin tjetër në shkresat e lëndës dhe përtej kapacitetit të provave të administruara dhe ato aktgjykime nuk specifikojnë çfarë forme të fajësisë iu është atribuuar të akuzuarve.

Gjykata Supreme e Kosovës vëren se përmbajtja e aktgjykimit është nënvizua në Nenin 396 të KPPK-së. Ky Nen parasheh se aktgjykimi duhet të ketë pjesën hyrëse, dispozitivin dhe arsyetimin. Secila nga këto pjesë duhet të përmbajë informata specifike të nënvizuara në pjesën tjetër të dispozitave të cilat po ashtu përfshijnë arsyetimin lidhur me dënimin.

Përmbajtja e obligueshme e dispozitivit është paraparë më tutje në nenin 396 paragrafët (3), (4) dhe (5) të KPPK-së.

(3) *Dispozitivi i aktgjykimit përfshin të dhënat personale të të akuzuarit (neni 203*



paragrafi 1 i këtij Kodi) dhe vendimin me të cilin i akuzuari shpallet fajtor për veprë penale për të cilën akuzohet, ose me të cilin lirohet nga akuza për atë veprë apo me të cilin refuzohet aktakuza.

(4) Kur i akuzuari është dënuar, dispozitivi i aktgjykimit përfshin të gjitha të dhënat e nevojshme të parapara në nenin 391 të këtij Kodi, ndërsa kur ai është liruar nga akuza ose akuza është refuzuar, dispozitivi i aktgjykimit përfshin përshkrimin e veprës për të cilën është akuzuar dhe vendimin për shpenzimet e procedurës penale me kërkesën pasurore juridike nëse një kërkesë e tillë është paraqitur.

Gjatë shqyrtimit të kësaj pike Gjykata Supreme nuk ka mundur të vërtetojë asnjë mungesë substanciale lidhur me dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar.


Në faqen 6 të aktgjykimit të lëshuar në shkallën e dytë i cili është konfirmuar në shkallën e tretë shkruan:

“Burim Ramadani, Arben Kiqina, Arsim Ramadani dhe Blerim Kiqina janë shpallur fajtorë për veprat penale pesë vrasje të rënda të qëllimshme dhe një vrasje të rëndë të qëllimshme në tentativë, në kundërshtim të nenit 30 par. 1 dhe 2 (pika 1) dhe 3 të LPK-së në lidhje me nenet 19 dhe 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, i aplikueshëm sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 (i dënueshëm edhe me nenet 146, 147 pikat 3 dhe 11 në lidhje me nenet 20 dhe 23 të KPPK-së), sepse ata së bashku kanë marrë jetën e Hamëz Hajrës, Miradije Hajrës, Xhevdet Hajrës, Mimoza Hajrës dhe Adelina Hajrës, dhe kanë tentuar ta marrin jetën e Pranvera Hajrës në mënyrë tinëzare duke ju zënë pritën atyre gjatë udhëtimit me veturë dhe duke shtënë në drejtim të tyre nga më shumë se një armë me breshëri plumbash me pushkë të kalibrit 7.36 x 39 mm, pa arritur që ta vrasin Pranvera Hajrën për shkak të rrethanave të intervenimit. Më 20 gusht 2001, rreth orës 23:00, përgjatë rrugës së pashtruar në mes të fshatrave Baicë dhe Tërstenik”.

Në këtë kuptim Gjykata Supreme gjen se në këtë lëndë dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është mjaft i qartë. Bëhet një referim adekuat i dispozitave të ligjit penal duke e sqaruar se çfarë forme e fajësisë është përcaktuar nga Gjykata.

Derisa ankuesit pretendonin cilësim të gabuar të veprës penale duke iu referuar “vrasjes së rëndë të qëllimshme” pasi që nuk është paraparë me dispozitat e ligjit penal, vendimi i gjykatës mbetet i qartë dhe në këtë mënyrë pa gabime sa i përket nenit 396 të KPPK-së. Në mënyrë që t'i shmangemi dyfishimit, çështja e cilësimit të veprës penale nuk është adresuar këtu, por është lënë kur të shqyrtohen shkeljet e pretenduara të dispozitave të ligjit penal.

Dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar në mënyrë të qartë tregon veprat për të cilat të pandehurit janë shpallur fajtorë, cilësimin juridik si dhe dispozitat mbi të cilat është bazuar dënimi. Për më tepër, dispozitivi përmban citime të fakteve dhe rrethanave të cilat përbëjnë elementet statusore të veprës penale dhe të atyre mbi të cilat varet zbatimi i dispozitës së veçantë të ligjit penal.



Siç është përcaktuar me aktgjykime të ndryshme dhe sipas praktikës ligjore, përshkrimi i fakteve dhe rrethanave që shtyjnë gjykatë në përfundim sa i përket fajësisë apo jo të të akuzuarit lidhur me veprën/at penale nuk duhet të përfshihen në dispozitiv, por ato patjetër duhet të adresohen në arsyetimin e aktgjykimit. Në këtë lëndë, në komponentin e arsyetimit gjykata ka shteruar të gjitha mundësitë gjatë përpilimit të arsyetimit duke treguar pse ka vendosur se i akuzuari ka vepruar në mënyrë të qëllimshme për t'i vrarë viktimat.

Rrjedhimisht, Gjykata Supreme mendon se pretendimi i mbrojtjes lidhur me shkeljen e ligjit të procedurës është jomeritor.

3. PAPANUESHMËRIA E DËSHMIVE TË “MB-së” DHE

H

Avokatët mbrojtës pretendojnë se pjesët e dëshmive të cilat janë paraqitur gjatë procedurave të mëparshme është dashur të shpallen të papranueshme. Në veçanti, deklaratat e dëshmitarit MB, pasi që sipas avokatit mbrojtës dëshmitari “MB” është liruar nga detyra për të dëshmuar sipas nenit 160 par. 1 nënpar. 1 të KPPPK-së. Avokatët mbrojtës kanë pretenduar në shkelje substanciale të nenit 364 par. 1 pikës 4, pasi që gjykata e shkallës së parë ka përjashtuar publikun pa lëshuar një vendim i cili i jep arsytet për përjashtimin e publikut gjatë dëgjimit të dëshmitarit “MB” dhe dëshmitares H më 27 maj 2004, përkatësisht në shqyrtimin special në dhjetor 2004.


Gjatë adresimit të pretendimeve të ankuesve mbi papranueshmërinë e deklaratave të “MB-së” dhe H, Gjykata Supreme e Kosovës e konsideron esenciale citimin e dispozitave relevante të cilat i përmendin personat të cilët lirohen nga detyra për të dëshmuar.

Neni 227 (1) i LPP-së i cili ka qenë i zbatueshëm gjatë fazës së hetimeve në pjesët përkatëse shkruan si në vijim:

(1) *Personat në vazhdim lirohen nga detyra për të dëshmuar:*

- 1) *Bashkëshorti/ja i të akuzuarit;*
- 2) *Personat e gjinisë së gjakut në vijë të drejtë të të akuzuarit, personat e gjinisë së gjakut në vijë anësore përfundimisht deri në shkallën e tretë, si dhe personat e gjinisë së krushqisë përfundimisht deri në shkallën e dytë.*
- 3) *I adoptuari dhe adoptuesi i të akuzuarit*
- 4) *Personi fetar mbi atë çka i pandehuri i është rrëfyer.*

Gjatë gjykimit, procedura e aplikueshme është Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK-ja, shih fusnotën 1). Dispozita përkatëse e KPPK-së mbi këtë pikë përkatësisht neni 160 par. 1 nënpar. 1 të KPPPK-së shkruan:



“ (1) Nga detyra e dëshmimit janë të liruar; ...

2) Personi i gjinisë së gjakut në vijë të drejtë me të pandehurin, personat e gjinisë së gjakut në vijë anësore deri në shkallë të tretë ose të gjinisë së krushqisë deri në shkallë të dytë, përveç kur procedura zbatohet për veprë penale për të cilën mund të shqiptohet dënimi me burgim me të paktën dhjetë vjet ose ai ishte dëshmitar i veprës penale kundër fëmijës që bashkëjeton ose është i afërt me të apo me të pandehurin; ...”.

Në lëndën në fjalë dëshmitarët “MB” dhe H nuk bien në asnjë dispozitë ligjore: qoftë të LPK-së apo KPPK-së mbi lirimi nga detyra e tyre për të dëshmuar. “MB-ja” dhe H nuk janë në lidhje me të pandehurit gjë që do t'i lironte ata në mënyrë ligjore nga detyra për të dëshmuar. Dispozitat e KPPK-së të cilave avokatët mbrojtës i referohen përjashtojnë mundësinë për t'u liruar nga detyra për të dëshmuar për *“një veprë penale që është e dënueshme me burgim prej së paku dhjetë vjet”*... . Në fakt, të pandehurit në këtë lëndë janë shpallur fajtorë për veprat penale të cilat janë të dënueshme me së paku dhjetë vjet burgim. Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se pranimi i atyre dëshmimeve nuk ngrit dyshime sa i përket pranueshmërisë së tyre formale.

Sa i përket përjashtimit të publikut gjatë shqyrtimeve derisa dëshmitarët “MB” dhe H kanë dëshmuar, vlen të theksohet fakti se “MB-së” i është dhënë statusi i dëshmitarit të mbrojtur në këtë lëndë. Për qëllime të mbrojtjes, gjykata ka konsideruar esenciale, me të cilën ky kolegji plotësisht pajtohet, përjashtimin e publikut nga e tërë pjesa në të cilën këta individë kanë dëshmuar. Personat pjesëmarrës përfshirë monitoruesit e OSBE-së të cilët janë lejuar të jenë të pranishëm janë udhëzuar në mënyrë të qartë që të mos t'ia zbulojnë emrat e dëshmitarëve askujt përfshirë edhe mediet. Përndryshe, gjykata ka paralajmëruar që mund të pasojnë pasoja serioze⁷.

Lidhur me këtë pikë neni 329 (6) i KPPK-së shkruan:

“Nga fillimi deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues me propozimin e palëve ose sipas detyrës zyrtare, por gjithnjë pas dëgjimit të tyre, mund të përjashtojë publikun gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor ose nga një pjesë e tij kur kjo është e nevojshme për:

1).....


.....

6) Mbrojtjen e të dëmtuarve ose dëshmitarëve siç parashihet në kapitullin XXI të këtij Kodi.

Më tutje, neni 333 (5) i KPPK-së shkruan:

“Aktvendimet e trupit gjykues gjithmonë shpallen dhe shënohen në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor me sqarim të shkurtër”.

⁷ Procesverballi i gjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjiilan i datës 27 maj 2004, faqet 6 dhe 7. *versione në gjuhën angleze.*



Nuk ka asnjë dyshim se të dy "MB" dhe H. H. H. bien nën kategorinë e palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve të mbrojtur siç përcaktohet në dispozitat e lartpërmendura të KPPK-së.

Siç është reflektuar fare mirë në procesverbalin e gjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, kryetari i kolegjit ka ftuar të gjitha palët që të deklarohen lidhur me çështjen dhe pastaj ka lëshuar një vendim i cili është pjesë e procesverbalit.

Gjithashtu vlen të theksohet fakti se trupi gjykues nuk ka pasur asnjë obligim për marrjen e pëlqimit nga të gjitha palët në procedurë gjatë lëshimit të vendimit për përjashtimin e publikut nga seanca.

Ky kolegji është i kënaqur dhe konsideron se gjykata e shkallës së parë i është përmbajtur dhe ka respektuar plotësisht dispozitat e KPPK-së.

4. PAPANUESHMËRIA E DEKLARATAVE TË BLERIM KIQINËS TË DATËS 4 KORRIK 2002 DHE 7 KORRIK 2002

Avokatët mbrojtës në kërkesat e tyre kanë kundërshtuar vlerën dëshmuuese të deklaratave të Blerim Kiqinës të datës 4 korrik 2002 dhe 7 korrik 2002 duke pohuar se ai i është nënshtruar presionit të tepërt nga policët të cilët janë marrë me rastin, duke pohuar se deklaratat nuk janë vërtetuar me dëshmi të tjera dhe prandaj, deklaratat nuk duhet ta formojnë bazën e një dënimi. Avokatët mbrojtës më tutje pretendojnë se avokati mbrojtës i caktuar sipas detyrës zyrtare i cili ishte prezent më 7 korrik 2002 nuk e ka mbrojtur klientin e tij në mënyrë efikase. Së fundi, disa nga avokatët mbrojtës pohojnë se edhe pse ata përfaqësojnë të pandehurë të tjerë ata është dashur të ftohen në shqyrtimin e datës 7 korrik 2002 para gjyqtarit hetues në këtë mënyrë duke iu mundësuar atyre që ta marrin në pareashtronin pyetje Blerim Kiqinës.

Lidhur me deklaratën e dhënë nga Blerim Kiqina më 4 korrik 2002, Gjykata Supreme e Kosovës në gjykatën e shkallës së dytë duke vendosur lidhur me ankesat ka marrë qëndrim me të cilin ky kolegji pajtohet se deklarata e lartpërmendur është e papranueshme për shkak të mungesës së kushteve formale. Ajo nuk do të thotë se deklarata është marrë në mënyrë të kundërligjshme dhe/ose se i pandehuri Blerim Kiqina i është nënshtruar presionit të tepërt nga policët të cilët janë marrë me rastin siç pretendohet nga avokatët mbrojtës. Pretendimet e tilla nuk mbështeten me asnjë dëshmi. Deklarata e marrë nga i pandehuri Blerim Kiqina thjesht nuk i përmbush të gjitha kushtet formale të cilat kërkohen me dispozitat e procedurës penale. Siç është konstatuar nga gjykata e shkallës së dytë, nuk mund të gjendet asnjë e dhënë në shkresat e lëndës që demonstroi se Blerim Kiqina është njoftuar në mënyrë të duhur lidhur me të drejtat para dhënies së deklaratës së tij. Prandaj, ky kolegji konsideron se deklarata e dhënë më 4 korrik 2002 është e papranueshme.



Lidhur me video xhirimin, Gjykata Supreme pajtohet me pohimin e avokatëve mbrojtës së video xhirimi i deklaratës së datës 4 korrik 2002, nuk është bërë sipas dispozitave të procedurës penale.

Ky kolegji ndan pikëpamjen e mëparshme me Gjykatën Supreme të Kosovës në një lëndë të lidhur me këtë e cila lidhur me temën e njëjtë përmban si në vijim:

“Autoriteti i vetëm kompetent për lejimin e xhirimit të një interviste është gjyqtari hetues. Mos respektimi i kësaj dispozite përbën shkelje procedurale”...⁸

Policia si duket kanë kontaktuar një prokuror para xhirimit të intervistës me Blerim Kiqinën. Megjithatë, nuk mund të konstatohet se autorizimi është marrë nga autoriteti kompetent pasi që kompetenca për një autorizim të tillë është e rezervuar për gjyqtarin hetues e jo për prokurorin publik.

Neni 87 par 1 i LPP-së thotë;

(1) Gjykatësi hetues mund të caktojë që zbatimi i veprimit hetues të incizohet me ndihmë të manjetoфонit. Për këtë gjë gjykatësi hetues do të njoftojë më parë personin i cili merret në pyetje, respektivisht dëgjohet.

Është e qartë se autorizim i këtillë nuk është dhënë nga gjyqtari hetues prandaj video-incizimi i deklaratës konsiderohet si i palejueshëm (papranueshëm).

Sa i përket deklaratës së datës 7 korrik 2002 të cilën e argumentojnë avokatët mbrojtës që do të duhej të paraqitej si e papranueshme pasi që avokati mbrojtës sipas detyrës zyrtare nuk e ka mbrojtur klientin e tij në mënyrë efikase nga këndvështrimi i Gjykatës Supreme ky argument është i pabazuar.


Ligji e parashikon që kryetari i gjykatës mund të shkarkoj avokatin e caktuar mbrojtës i cili nuk i kryer detyrat e tij me rregull me kërkesën e të pandehurit apo me miratimin e tij apo të saj.

Në këtë pikë neni 72 (4) i LPP-së thotë;

“Kryetari i gjykatës, në bazë të kërkesës të të pandehurit ose me pëlqimin e tij, mund të shkarkojë mbrojtësin e caktuar i cili nuk e ushtron rregullisht detyrën. Në vend të mbrojtësit të shkarkuar, kryetari i gjykatës do të caktojë mbrojtësin tjetër. Mbi shkarkimin e mbrojtësit i cili është avokat do të njoftohet Oda e Avokatëve”.

Nuk ekziston dëshmi në shkresat e lëndës e cila tregon pakënaqësinë e të pandehurit me performancën e avokatit mbrojtës të caktuar sipas detyrës zyrtare dhe/ose çfarëdo rrethane që do të pasqyrojnë qëndrimin e avokatit të mëparshëm mbrojtës të dyshimtë në këtë lëndë.

⁸ Jeton Kiqina case, Judgment Pkl-Kzz 31/10, dated 01 November 2010, page 9. English version



Asnjë shkelje e të drejtave të mbrojtës të garantuara prej ligjit të aplikueshëm nuk mund të vërehet në këtë lëndë. Prandaj, Gjykata Supreme e konsideron këtë pikë si të pabazuar.

Sa i përket pretendimit mbi praninë e avokatëve mbrojtës që përfaqësuan të pandehurit tjerë në seancën dëgjimore të 7 korrikut 2002, ky panel vëren se gjykata nuk ka pasur obligim t'i ftoj avokatët tjerë mbrojtës në seancën dëgjimore të pandehurit të ndryshëm prej atij që ata e përfaqësojnë gjatë fazës hetimore. Pretendimi i avokatëve mbrojtës se ata kanë qenë të privuar nga mundësia e marrjes në pyetje nga pala kundërshtare është jo meritator. Vetë fakti se avokatët tjerë mbrojtës nuk ishin të pranishëm kur Blerim Kiqina e dha dëshminë e tij para gjyqtarit hetues më 7 korrik 2002, nuk e ngrit asnjë çështje lidhur me lejueshmërinë e asaj deklarate. Avokatëve mbrojtës ju është dhënë mundësi të mjaftueshme gjatë rrjedhës së gjykimit për të marr në pyetje nga pala kundërshtare Blerim Kiqinën dhe t'i shprehin kontestimet e tyre.

Prandaj, Gjykata Supreme e konsideron këtë pikë si të pabazuar.

5. MUNGESA E DASHJES (QËLLIMIT), MOTIVIT, LIDHJES SHKAKORE DHE MUNGESA E ARSYETIMIT PËR TË PËRKRAHUR GJETJET FAKTIKE

Avokatët mbrojtës pohojnë se aktgjykimet nuk përmbajnë arsyetim të mjaftueshëm për përkrahjen e gjetjeve faktike që janë vërtetuar nga gjykatat. Avokatët mbrojtës e argumentojnë mungesën e dashjes, motiveve dhe mungesën arsyetimit të duhur lidhur me lidhjen shkakore në mes të veprimeve dhe të pasojave.

Vlen të përmendet që argumente të këtilla janë të lidhura me bazën e vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike për të cilën në këtë fazë të procedurës ankesa mund të mos të lejohet.

Siç është treguar më lart, Gjykata Supreme e Kosovës në vlerësimin e saj është e kufizuar nga neni 451 dhe neni 455 i KPPK-së në lidhje me bazat e kërkesës dhe të argumenteve të ngritura nga pala kërkuese.

Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se ankesat mbi këtë pikë si të papranueshme.

6. PËRJASHTIMI NGA DETYRA PËR TË DËSHMUAR NGA ANËTARËT E FAMILJES KIQINA.

Avokatët mbrojtës e ngritën çështjen e anëtarëve të familjes Kiqina (Jetoni, Florimi dhe Blerimi) dhe pretenduan përjashtimin nga detyra për të dëshmuar në përputhje me nenin 227 të LPP-së dhe nenit 229 dhe 231 të LPP-së pasi që ata nuk janë informuar për detyrat e tyre si të afërm familjar që mos të dëshmojnë kundër njëri-tjetrit.

Neni 227 (1) i LPP-së të cilit avokatët mbrojtës i referohen i numëron personat që janë të përjashtuar nga detyra për të dëshmuar.



Në pjesën përkatëse, LPP-ja thotë si në vijim:

(2) *Personat në vijim janë të liruar nga detyra e dëshimit:*

- 1) *Bashkëshorti/ja i/e të pandehurit;*
- 2) *Personat e gjinisë së gjakut në vijë të drejtë të të pandehurit, personat e gjinisë së gjakut në vijë anësore përfundimisht deri në shkallën e tretë, si dhe personat e gjinisë së krushqisë përfundimisht deri në shkallën e dytë.*
- 3) *I adoptuari dhe adoptuesi i të pandehurit*
- 4) *Personi fetar mbi atë çka i pandehuri i është rrëfyer.*

Është i njohur dhe i pakontestueshëm fakti që të akuzuarit Florim Kiqina dhe Arben Kiqina janë vëllezër. E njëjta vlen për Burim Ramadanin dhe Arsim Ramadanin. I akuzuari Blerim Kiqina është djali i axhës së Florim Kiqinës, Arben Kiqinës dhe Jeton Kiqinës. Adem Kiqina është axha i Jeton Kiqinës. Xhevdet Kiqina dhe Adem Kiqina janë vëllezër. Blerim Kiqina dhe Jeton Kiqina janë djemtë e axhës të Xhevdet Kiqinës. Florim Kiqina dhe Blerim Kiqina janë djemtë e axhës të Jeton Kiqinës.


Një gjendje e tillë faktike tregon se Florim Kiqina dhe Blerim Kiqina janë të afërm në gjinë anësore të shkallës së katërt të të pandehurit Jeton Kiqina. Si pasojë, ata nuk bien në kategorinë që janë të përjashtuar nga detyra e tyre për të dëshmuar.

Për këto arsye, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron që gjykatat në shkallët e mëparshme në mënyrë të rregullt kanë gjetur se autoritetet që kane zhvilluar intervistat kanë vepruar në pajueshmëri me dispozitat ligjore të procedurës të aplikueshme në atë kohë.

Sa i përket deklaratës së Florim Kiqinës së datës 27 gusht 2001, Gjykata Supreme e Kosovës vëren se ai është intervistuar në cilësinë e dëshmitarit. Florim Kiqina ishte udhëzuar në mënyrë të rregullt me të drejtat e dëshmitarëve duke përfshirë të drejtën e mos përgjigjes në pyetje. Më 6 korrik 2002 Florim Kiqina është dëgjuar në cilësinë e të dyshuarit. Në mënyrë të dukshme Florim Kiqina është njoftuar me të drejtat e të dyshuarit kur ka qenë i intervistuar në atë cilësi gjë që gjithashtu është konfirmuar nga dokumenti që ai vet e ka nënshkruar në fund.

Gjykata Supreme e Kosovës konsideron që autoritetet që kanë kryer intervistat në tërësi i janë bindur dispozitave të aplikueshme procedurale. Ndryshimi në statusin e të intervistuesit prej atij të dëshmitarit në atë të dyshuarit nuk e bën deklaratën e cila është marr në mënyrë të ligjshme dhe në pajtim me dispozitat procedurale përkatëse për statusin e intervistuesit në kohën e marrjes së intervistës të papranueshme. Prandaj, i mbetet trupit gjykues të vendos se çfarë peshe t'i atribuoj asaj deklaratë dhe/ose të vlerësoj besueshmërinë e saj. Prandaj, pranimi i këtyre dëshmimeve nuk i ngrit dyshimet sa i përket jueshmërisë e tyre.

Prandaj në përputhje me rrethanat, Gjykata Supreme e konsideron kërkesën e mbrojtjes të pabazuar në këtë pikë.



8. PAPANUESHMËRIA E DEKLARATAVE TË ZYRTARIT POLICOR NDËRKOMBËTAR RODNEY HILTON DHE LISTA E THIRRJEVE NË TELFONIN MOBIL .

Avokati mbrojtës pohon papranueshmërinë e deklaratës së zyrtarit policor ndërkombëtar Rodney Hilton të datës 6 dhe 7 gusht 2002. Pretendohet që propozimi për përjashtimin e gjyqtarit hetues ishte bërë gjatë rrjedhës së seancës dhe pasi që nuk është vendosur për atë, sipas avokatit mbrojtës vazhdimi i seancës është në kundërshtim të ligjit në aspektin e nenit 43 të LPP-së.

Përveç kësaj, avokatët mbrojtës pretendojnë që lista e thirrjeve në telefonin mobil është siguruar në mënyrë të paligjshme nga PTK-ja⁹. Sipas avokatit mbrojtës asnjë kërkesë nuk është bërë nga gjyqtari hetues për një informacion të tillë nga PTK-ja.

Në lidhje me papranueshmërinë e Deklaratës së dhënë nga zyrtari policor ndërkombëtar Rodney Hilton, dispozitat përkatëse të LPP-së parashikojnë:

Neni 40 (1) i LPP-së:

(1) Gjykatësi ose ndihmës gjyqtari, porsa mëson se ekziston ndonjëri nga shkaqet për përjashtim nga neni 39, pikat 1 dhe 5 të këtij ligji, ka për detyrë të ndërpresë çdo veprim në atë lëndë, dhe për këtë gjë të njoftojë kryetarin e gjykatës, i cili do t'i caktoj zëvendësin. Kur është fjala mbi përjashtimin e kryetarit të gjykatës, ai do t'i caktoj vetës zëvendësin midis gjykatësve të asaj gjykatë, e kur kjo gjë nuk është e mundur, do të kërkojë nga kryetari i gjykatës së drejtpërdrejtë më të lartë që të caktoj zëvendësin.

(2) Kur gjykatësi apo ndihmës gjyqtari konsiderojnë se ekzistojnë rrethana tjera të cilat justifikojnë përjashtimin e tij (neni 39, pika 6) do të njoftojë për këtë gjë kryetarin e gjykatës.

Neni 43 i LPP-së thotë:


Kur gjykatësi ose ndihmës gjyqtari mëson se është bërë kërkesa për përjashtimin e tij, ka për detyrë që menjëherë të pezullojë çdo veprim në lëndë, e kur është fjala mbi përjashtimin nga neni 39, pika 6 e këtij ligji, deri në nxjerrjen e aktvendimit mbi kërkesën, mund të ndërmarrë vetëm ato veprime për të cilat ekziston rreziku nga shtyrja.

Neni 39 i LPP-së thotë:

Gjykatësi ose ndihmës gjyqtari nuk mund të ushtrojë detyrat gjyqësore:

.....
.....
.....

⁹ PTK-ja – Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës.



.....

(6) kur ekzistojnë rrethana të cilat shkaktojnë dyshim në objektivitetin e tij.

Duke e adresuar këtë pikë (çështje) paneli e gjen të nevojshme t'i referohet lëndës së lidhur penale të shqyrtuar nga Gjykata Supreme e Kosovës ku është gjykata thekson¹⁰:

“propozim për përjashtim i bërë në bazë të asaj që është vendosur në nenin 39 paragrafit 6 të LPP-së nuk kërkon ndërprerjen e aktivitetit ligjor që është në proces e sipër i cili ka filluar para se të bëhet një propozim i tillë. Neni 40 Paragrafi 2 i LPP-së në mënyrë specifike e parasheh obligimin e gjyqtarit apo të gjyqtarit porotë të cilët konsiderojnë se ekzistojnë rrethana tjera të cilat justifikojnë përjashtimin e tij (neni 39 pika 6) ai/ajo do të njoftojë për këtë gjë kryetarin e gjykatës.”

Në bazë të shkresave të lëndës është e dukshme që gjyqtari i atëhershëm hetues në mënyrë të rregullt ka informuar Kryetarin e Gjykatës për propozimin i cili pastaj është refuzuar si i pabazuar nga Kryetari me 11 gusht 2002.

Gjykata Supreme e Kosovës konsideron që vazhdimin në dëgjimin e Z. Rodney pasi që avokatët mbrojtës kanë ushtruar propozim për përjashtim të gjyqtarit të atëhershëm hetues nuk është në kundërshtim të nenit 39, pikës 6 të LPP-së. Siç është vërtetuar në shkallët e mëhershme Z. Rodney ishte gati ta përfundoj misionin e tij dhe është e qartë se marrja e deklaratave do të ishte e vështirë përderisa vonesat do të ishin të paevitueshme. Prandaj, Gjykata Supreme konstaton se gjykata ju bind kërkesave të përcaktuara ligjore për të evituar shtyrjet e panevojshme.


Sa i përket listës së thirrjeve, është e qartë prej shkresave të lëndës që letra nga gjyqtari hetues e datës 23 nëntor 2001 i ishte dërguar tek Drejtoria për Çështje të Infrastrukturës dhe Komunikimeve duke kërkuar detajet e thirrjeve të bëra dhe marra të lidhur për periudhën në mes të 19 dhe 21 gusht 2010 për numrat e renditur të VALË-s.

Siç është treguar në përgjigjen prej PTK-së e cila është pjesë e shkresave të lëndës, kërkesa e gjyqtarit hetues ishte realizuar dhe rezultatet i janë vënë në dispozicion gjykatës. Aktivitete të tilla hetuese nga këndvështrimi i Gjykatës Supreme të Kosovës ishte në pajtueshmëri të plotë me dispozitat e LPP-së të cilat ishin në fuqi në atë kohë. Asnjë shkelje e të drejtave të njeriut nuk mund të zbulohen si rezultat i një veprimi të këtillë. Prandaj, kërkesa në këtë pikë është e pabazuar.

II. SHKELJET E PRETENDUARA TË DISPOZITAVE TË LIGJIT PENAL

10. MOSPËRPUTHJA ME NENIN 3 (2) KPPK-së - PARIMI “IN DUBIO PRO REO”.

¹⁰ Lënda e Jeton Kiqinës, Aktgjykimi Pkl-Kzz 31/10 i datës 1 nëntor 2010, faqe 11 dhe 12 të versionit në gjuhën angleze



Avokatët mbrojtës pohojnë se është bërë shkelje e ligjit penal pasi që parimi i theksuar në nenin 3 (2) të KPPK-së që dyshon lidhur me faktet relevante të lëndës apo ligji penal do të duhej të interpretohet në të mirë të pandehurit – parimi “*in dubio pro reo*”.

Sa i përket pretendimit lidhur me ekzistencën e fakteve relevante për lëndën të referuara nga avokati mbrojtës, Gjykata Supreme e Kosovës e gjen vendimtare të përsërisë prapë që kontestimi i aktgjykimeve mbi bazë të gjendjes faktike është i papranueshëm në pajtim me nenin 451 (2) të KPPK-së. Si pasojë, pretendimet e lidhura me vërtetimin e gjendjes faktike nuk do të jenë subjekt i rishikimit në këtë fazë të procedurës.

Sa i përket aplikimit të “*ligjit më të favorshëm*”, Gjykata Supreme e Kosovës pajtohet me avokatin mbrojtës që në rastin e ndryshimit në ligjin e aplikueshëm në lëndën në fjalë para vendimit të formës së prerë, do të aplikohet ligji më i favorshëm për autorin e krimit.

Në lëndën në fjalë, padyshim ligji në fuqi në kohën e ngjarjes është shumë më i favorshëm për të pandehurit se sa ligji që ka hyrë në fuqi para vendimit të formës së prerë. Gjykata Supreme e Kosovës konsideron që ligji material i aplikuar në lëndë është shumë më i favorshëm se sa ligji që ka hyrë në fuqi kur procedurat janë kryer. Çdo shtjellim i mëtutjeshëm në këtë çështje do të ishte i tepërt dhe thjesht i panevojshëm.


Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se kërkesa në këtë pikë është e pabazuar.

11. CILËSIMI I GABUESHËM JURIDIK I VEPRAVE PENALE

Avokatët mbrojtës pretendojnë se aktgjykimi nuk përmban përcaktim të përpiktë të veprës penale pasi që nuk ekziston “*vrasje e rëndë me qëllim*” sipas dispozitave të ligjit penal dhe se arsytimi i aktgjykimit është i paqartë, në kundërshtim me deklaratat e të akuzuarve, dëshmitarëve, dhe dokumentacionit tjetër në shkresat e lëndës dhe përtej kapacitetit të dëshmimeve të administruara dhe këto aktgjykime nuk kanë specifikuar se çfarë forme të fajësisë i vishet të akuzuarit.

Pretendimi në përcaktimin e përpiktë të veprës penale pasi që nuk ekziston “*vrasje e rëndë me qëllim*” sipas dispozitave të ligjit penale, Gjykata Supreme e Kosovës e konsideron këtë argument pa meritë. Në mënyrë të dukshme aktgjykimet e kundërshtuara i adresohen dispozitave përkatëse ligjore të ligjit penal duke mos lënë dyshim në ligjin e mëhershëm të aplikueshëm penal.

Të pandehurit Burim Ramadani, Arben Kiqina, Arsim Kiqina dhe Blerim Ramadani janë shpallur fajtor nga aktgjykimi Ap-Ka 293/06 i Gjykatës Supreme për pesë vepra penale të Vrasjeve të rënda dhe një tentim vrasje e rëndë në pajtim me nenin 30 par. 1, 2 (pika 1) dhe 3 e Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (LP KSAK) e lidhur me nenin 19 dhe 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste të Jugosllavisë (KP RFSJ). Për këto vepra penale të akuzuarit Burim Ramdani, Arben Kiqina, Arsim Ramadani secili prej tyre është dënuar me dënim unik prej 30 vjetëve me burgim dhe i akuzuari Blerim Kiqina ishte dënuar me 11 vjet burgim.



Kjo gjykatë konstaton se veprimet e të akuzuarit përbëjnë vepra penale për të cilat të akuzuarit janë shpallur fajtor bazuar në dëshmitë që janë siguruar, administruar dhe vlerësuar në mënyrë të rregullt nga trupi gjykues. Gabimi në aplikimin e ligjit në mënyrë të rregullt është korrigjuar nga gjykata gjatë rrjedhës së procedurës ankimore. Gjykata Supreme e Kosovës është e kënaqur me ri-cilësimin e shkallës së dytë prandaj edhe konstaton se shkalla e dytë nuk bëri gabim të ligjit.

Kështu që kërkesat janë të pabaza në këtë çështje.

12. MOSBINJDJA NDAJ RREGULLAVE PËR SHQIPTIMIN E DËNIMIT UNIK

Avokatët mbrojtës pretendojnë dështimin e gjykatave për t'ju bindur rregullave për shqiptimin e dënimit unik siç parashihet me nenin 48 par 1 të KP të RSFJ-së i cili korrespondon në tërësi me nenin 71 par 1 të KPPK-së. Avokatët mbrojtës pretendojnë që gjykatat në shkallën e mëhershme nuk e kanë dënuar të akuzuarit për secilën vepër penale dhe pastaj ta aplikojnë dënimin unik. Për më tepër, avokati mbrojtës pohon se për shkak të lirimit të pjesshëm në shkallën e dytë, Gjykata Supreme është dashur ta zvogëlojë dënimin.


Sa i përket pretendimit në lidhje me dënimin unik, është e qartë se gjykata e shkallës së dytë pas shqiptimit të dënimit për të akuzuarit veç e veç për pesë veprat penale të vrasjes dhe të një tentim vrasjeje i ka dënuar të akuzuarit Burim Ramdani, Arben Kiqina, Arsim Ramadani me një dënim unik prej 30 vjetëve me burgim dhe i akuzuari Blerim Kiqina ishte dënuar me 11 vjet burgim.

Ky kolegji konstaton se gjykata në tërësi ka vepruar në pajtim me dispozitat e aplikueshme procedurale lidhur me unifikimin e dënimeve. Kolegji është i kënaqur dhe konsideron se gjykatat në shkallën e mëparshme janë mbështetur dhe vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e KPPK-së.

Prandaj pohimi i avokatëve mbrojtës në këtë pikë është jomeritor.

Sa i përket zvogëlimin të dënimit për shkak të lirimit të pjesshëm nga një apo më shumë veprave penale, Gjykata Supreme konsideron se nuk ekziston asnjë obligim që gjykata të zvogëlojë dënimin për shkak të lirimit të pjesshëm. Gjykata është e obliguar vetëm me dënimin maksimal.

Prej asaj që u tha më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
PKL-KZZ 30/10, i datës 1 shkurt 2011

Kryetari i kolegjit:


Martti Harsia
Gjyqtar i EULEX-it

Procesmbajtës:

Adnan Isufi
Këshilltar ligjor

Anëtarët e kolegjit:

Charles L. Smith III,
Gjyqtar i EULEX-it



Lars Dahlstedt
Gjyqtar i EULEX-it

Emine Mustafa
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Salih Toplica
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

Mjeti juridik

Kërkesa për mbrojtje të ligshmërisë nuk mund të ushtrohet kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilën është vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligshmërisë (Neni 451 paragrafi (2) të KPPK-së).